

AKT THEMELIMI DHE STATUTI: "YOUR TAXI" SH.P.K.

---

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I  
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
"YOUR TAXI" SH.P.K

---

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI: "YOUR TAXI" SH.P.K**

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "YOUR TAXI"  
SH.P.K**

**STATUT**

**PER KRIJIMIN E PERSONIT JURIDIK, SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE  
KUFIZUAR: "YOUR TAXI" SH.P.K**

Sot më datë 18.09.2023, unë shtetasi si më poshtë, vijon:

**Z. Shkelzen Narazani, lindur me 18/12/1981, në Durrës, qytetar shqiptar, banues në Durrës, mbajtes i leternjoftimit me numër Personal I11218058W, madhor e me zotësi të plotëjuridike për të vepruar;**

**Në mbështetje të dispozitave ligjore të Kodit Civil në Ligjin Nr. 9901, datë 18.09.2023, vendosë themelimin e Shoqërisë Tregtare "YOUR TAXI" Sh.p.k., shoqëri private e së drejtës Shqiptare, krijimi, funksionimi i së cilës përcaktohet si më poshtë vijon:**

**KREU**

**EMRI I SHOQERISE, SELIA, KOHEZGJATJA, OBJEKTI**

**NENI 1**

**EMERTIMI I SHOQERISE**

- 1.1 Emri i shoqërisë me përgjegjësi së kufizuar është **"YOUR TAXI"** SH.P.K (më poshtë e quajtur "Shoqëria"), person juridik privat I së drejtës Shqiptare, I themeluar dhe do të ushtrojë veprimtarinë në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë. Kjo shoqëri në llojin e saj është Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuara.

**NENI 2**

**SELIA**

- 2.1 Lagjia nr 14 Rruga Hazis Shkupi Rajoni 5, Shkozë Durrës, Shqipëri.
- 2.2 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë mbi transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjetër. Organi administrues i Shoqërisë mund të themelojë ose mbyllë dege dhe/ose zyra perfaqesimi, brenda apo jashtë Republikës së Shqipërisë.

## AKT THEMELIMI DHE STATUTI: "YOUR TAXI" SH.P.K

### NENI 3

#### VULA E SHOQERISE

3.1 Shoqëria ka vulën e saj, do të jetë si vijon: **"YOUR TAXI" SH.P.K.**

3.2 Të gjitha Aktet dhe dokumentat që do të nxjerrë Shoqëria drejtuar palëve të treta dhe publikut duhet të tregojnë qartë dhe të lexueshëm emërtimin (llojin) e Shoqërisë dhe pas emrit do të jenë fjalët "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuara" ose shkurtimi sh.p.k. **"YOUR TAXI" SH.P.K.**

3.3 Shoqëria ka adresën e saj elektronike: [narazanixheni@gmail.com](mailto:narazanixheni@gmail.com)

3.4 Shoqëria ka nr. Kontakt të saj: **+355693872569**

### NENI 4

#### OBJEKTI I SHOQERISE

4.1 Shoqëria ka për objekt te saj kryerjen e të gjitha aktiviteteve që një shoqëri me përgjegjësi te kufizuar mund te ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, brënda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke u fokusuar kryesisht në:

##### a) **Sherbimin Taxi**

4.2 Për përmbushjen e objektit të saj Shoqëria:

- a) Mund të marrë pjesë dhe te jete e interesuar ne shoqeri dhe sipermarrje, shqiptare apo te huaja, qe kryejne aktivitete te njëjta, te ngjashme apo te lidhura me aktivitetin e saj ose te subjektevepjesemarrrese;
- b) Mund të lidhë kontrata shitblerje, përdorimi, shkëmbimi, sipërmarrje apo marrëveshje të tjera me investitorë, bashkë investitorë, pronarë trualli apo objektesh, operatorë dhe administrues te strukturave ndertuese;
- c) Mund te kryejë te gjithë veprimet e nevojshme ose të dobishme ose qe kanë të bëjnë, përfshirë por pa u kufizuar në ofrimin e garancive reale dhe/ose personale për detyrimet e veta dhe së të tretëve, veprime me pasuri të luajtshme, te paluajtshme, tregtare dhe cdo veprim tjetër që ka të bëjë me objektin e saj ose që mundëson një përdorim më të mirë të strukturave dhe/ose burimeve nëpërmjet shoqërive ose sipërmarrjeve në të cilat, direkt apo indirekt, Shoqëria ka pjesëmarrje apo kontrollin e tyre.

4.3 Shoqëria mund te veprojë ne Shqipëri dhe jashtë saj dhe te kryejë do aktivitet tjetër te lidhur, ndihmës me qëllim te përmbushe ose te jetë i dobishëm për përmbushjen e objektit te saj.

## AKT THEMELIMI DHE STATUTI: "YOUR TAXI" SH.P.K

### NENI 5

#### KOHEZGJATJA E SHOQERISE

5.1 Shoqëria do të zhvillojë Veprimtarinë e saj për një kohë pa afat.

5.2 Ajo mund të shpërndahet para afatit me vendim të Ortakut, ose per shperndarje e saj e percakton vetë legjislacioni ne fuqi.

### KREU II

#### KAPITALI, KALIMI I KUOTAVE, ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT

### NENI 6

#### KAPITALI I SHOQERISE

6.1 Kapitali i Shoqërisë ndahet në një numët kuotash, në raport me kontributin dhënë nga cdo ortak në Shoqëri. Cdo Ortak zotëron një kuotë të vetme në Shoqëri.

Bashkëzotëruesit e një kuote, sipas nenit 72, të këtij ligji, gëzojnë cilësinë si një ortak I vetëm.

6.2 Kapitali fillestar për ushtrimin e veprimtarisë së Shoqërisë është 1.000 (nje mijë) Lekë. Pjesëmarrja e themeluesit ne Kapitalin e Shoqërise është në përputhje me kontributet e tij si më poshte:

1. Ortaku Vetëm Themelues **Z. Shkelzen Narazani, lindur më, 18/12/1981, në Durres, qytetar shqiptar, banues ne Durres, mbajtes I letërnjoftimitme numër Personal: I11218058W**, Zotërues I një kuote të vetmë me vlerë nominale 1.000 (nje mijë) lekë dhe përfaqëson 100% të Kapitalit Themeltar.

Kapitali i Shoqërisë nënshkruhet menjëhere dhe do të paguhet nga ortaku që zotëron, 100 % (njqind per qind) të kontributeve në kapitalin e shoqerisë.

6.3 Në rast zmadhimi apo zvogëlimi të kapitalit themeltar te Shoqërisë, ortakët do të kenë të drejtën e nënshkrimit të zmadhimit apo zvogëlimit të kapitalit në përpjesëtim të drejte me pjesëmarrjen që zotëron secili në kapitalin e Shoqërisë.

## **AKT THEMELIMI DHE STATUTI: "YOUR TAXI" SH.P.K**

### **NENI 7**

#### **KALIMI I KUOTAVE ME TRASHËGIMI OSE SI PASOJE E FALIMENTIMIT**

- 7.1 Në rast se një ortak, apo një bashkëzoterues i një kuote humb jetën, trashëgimtarët e tij do të jenë të vetmët persona, që do ti njihet titulli mbi kuotën nga Shoqëria por asnjë nga këto parashikime nuk cliron përgjegjësitë e trashëgimtarëve nga cdo detyrim i mbartur nga kuota e zotëruar. Në rastin e vazhdimit të Shoqërisë me disa trashëgimtare të ortakut që ka humbur jetën, trashëgimtarët duhet të caktojnë një përfaqësues të përbashkët.
- 7.2 Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e humbjes së jetës ose falimentimit të një ortaku mund të zgjedhe të behet zoterues i kuotes ose të kerkoje regjistrimin e kuotes ne emer të nje personi tjetër të caktuar prej tij si perfitues i kuotes . Nese personi i mesiperm zgjedh të behet zoterues i kuotes, ai njofton Shoqerine ne lidhje me kete zgjedhje. Nese personi i mesiperm zgjedh të kerkoje regjistrimin e kuotes ne emer të nje personi tjetër atehere ai duhet ta kryeje ate nepermjet nje akti të vlefs hem të transferimit të kuotes.
- 7.3 Personi që fiton të drejtat mbi një kuotë si pasojë e humbjes së jetës ose falimentimit të një ortaku do të kete të drejtat që gezonte zoteruesi i kuotes, duke perjashtuar të drejten e pjesemarrjes ose të votes ne do mbledhje të Asamblese se Pergjithshme, deri ne momentin e regjistrimit ne regjistrin tregtar si zoterues i kuotes.

### **NENI 8**

#### **ZMADHIMI I KAPITALIT**

- 8.1 Asambleja e Pergjithshme mund të zmadhoje kapitalin e Shoqerise, me kuorumin e percaktuar ne nenin 9.12 të ketij Akt Themelimi dhe Statuti. Vendimi i Asamblese se Pergjithshme për zmadhimin e kapitalit do t'i komunikohet me shkrim ortakeve që janë thirrur por nuk ishin të pranishëm në mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme që vendosi për zmadhimin e kapitalit.
- 8.2 Në rast zmadhimi të kapitalit, të gjithë ortakët do të kenë të drejtën të nënshkruajnë zmadhimin e kapitalit, në para ose me kontribute në natyrë, në përpjesëtim të drejtë me kuotat që zoterojnë në Shoqëri.
- 8.3 Në rast se disa ortake heqin dorë nga e drejta e nënshkrimit të pjesës së tyre, kapitali i panëshkruar mund të nënshkruhet nga ortakët e tjerë . Në këtë rast, këta ortake mund të ushtrojnë serish të drejtën për nënshkrimin e kapitalit, në përpjesëtim të drejtë me kuotat e pjesemarrjes në Shoqëri.

### **NENI 9**

#### **ZVOGELIMI KAPITALIT**

- 9.1 Asambleja e Pergjithshme mund të zvogeloje kapitalin e Shoqerise, me kuorumin e percaktuar ne nenin 9.12 të ketij Akti Themelimi dhe Statuti. Në do rast, kapitali i Shoqerise nuk mund të zvogelohet nën kufirin e percaktuar me ligj.
- 9.2 Ortakët e perballojnë zvogelimin e kapitalit të Shoqerise, në përpjesëtim të drejtë me pjesemarrjen e tyre në kapitalin e Shoqerise.

## AKT THEMELIMI DHE STATUTI: "YOUR TAXI" SH.P.K

### KREU III

#### ASAMBLEJA E PERGJITHSHME NENI 10 ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

- 10.1 Asambleja e Përgjithshme është organi vendimmarrës i Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme vendos mbi të gjitha çështjet për të cilat është kompetente sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë, sipas këtij Akt Themelimi dhe Statuti dhe/ose do marrëveshje midis ortakëve të Shoqërisë.
- 10.2 Cdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, të shprehe vullnetin e tij si dhe të votojë në përputhje me pjesët e kapitalit që ai zotëron në Shoqëri.
- 10.3 Cdo ortak mund të përfaqësohet nga një ortak tjetër ose nga një përfaqësues i deleguar me prokurë me shkrim.
- 10.4 Ortaku nuk mund të delegojë të drejtën e votes për një pjesë të kuotave të tij të kapitalit, nëse ai voton personalisht për pjesën e mbetur.
- 10.5 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahet brënda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ortakët ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme nepermjet mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën (*conference call()*) audio ose video, në përputhje me legjislacionin për shoqëritë tregtare dhe komunikimet elektronike. Mbledhja e Asamblese së Përgjithshme dote quhet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari i saj dhe Sekretari i mbledhjes, me qëllim që të hartohet dhe të nënshkruhet procesverbali përkatës.
- 10.6 Asambleja e Përgjithshme mund të thirret nga Administratori/et ose nga ortakët që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit të Shoqërisë. Thirrja e mbledhjes së Asamblese së Përgjithshme duhet të bëhet nëpërmjet njoftimit me shkrim ose me mjete elektronike, dërguar secilit prej ortakëve në adresat e njoftuara Shoqërisë, të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e saj. Njoftimi duhet të përmbajë rendin e ditës, vendin, datën dhe orën e mbledhjes.
- 10.7 Asambleja e Përgjithshme do të mbledhet rregullisht, pavaresisht nga keto formalitete, në rast se të gjithë ortakët apo përfaqësuesit e tyre janë të pranishëm dhe bien dakord për rendin e ditës.
- 10.8 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme kryesohen nga Administratori/ët. Asambleja e Përgjithshme cakton një sekretar për do mbledhje midis personave të pranishëm.
- 10.9 Vendimet e Asamblese së Përgjithshme duhet të jenë me shkrim dhe të firmosen nga kryetari dhe sekretari. Me kërkesë të ortakëve, vendimet duhet të përshijne dhe deklaratat apo verejtjet e tyre.
- 10.10 Asambleja e Përgjithshme mbledhet të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.
- 10.11 Asambleja e Përgjithshme, në rastin e vendimeve që kërkojnë shumicën e zakonshme, merr vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote ose përfaqësuesit e tyre, që zotërojnë me shumë se 30% (tridhjetë për qind) të kapitalit të Shoqërisë, përveç rasteve të parashikuara më poshtë në nenin 9.12. Në rast se ky kuorum nuk arrihet, Asambleja e Përgjithshme thirret në një mbledhje të dytë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga mbledhja e parë.
- 10.12 Asambleja e Përgjithshme vendos me votat pro të  $\frac{3}{4}$  të ortakëve pjesëmarrës apo të

## **AKT THEMELIMI DHE STATUTI: "YOUR TAXI" SH.P.K**

përfaqesuar që zotërojnë më shumë se 50% të kapitalit të Shoqërisë për ndryshimin e këtij Akt Themelimi dhe Statuti, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.

### **KREU IV ADMINISTRIMI I SHOQERISE**

#### **NENI 11 ADMINISTRIMI I SHOQERISE**

- 11.1** Shoqëria administrohet nga një apo më shumë Administratorë të cilët zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme për një periudhë prej; **5 (pesë) vjetësh** . **Administratori mund të rizgjidhet dhe shkarkohet në çdo kohë nga Asambleja e Përgjithshme.**
- 11.2** Administratori zotëron kompetenca të plota në lidhje me administrimin e Shoqërisë dhe mund të kryejë të gjitha aktet që konsideron të nevojshme për realizimin e objektivit të Shoqërisë, përveç; atyre që ligji apo ky Akt Themelimi dhe Statuti ia rezervon Asamblese së Përgjithshme apo organeve të tjera të Shoqërisë.
- 11.3** Administratori vepron në përputhje me politikën tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori është përgjegjës për veprimet e kryera në administrimin e Shoqërisë. Administratori mund të delegojë persona të tretë për kryerjen e veprimeve dhe akteve që kanë të bëjnë me administrimin e Shoqërisë, duke mbajtur përgjegjësi për të gjitha veprimet e kryera nga të tretët e deleguar për administrimin e Shoqërisë.
- 11.4** Administratori do të veprojë në çdo kohë vetëm në interesin më të mirë të Shoqërisë. Në rast konflikti të interesit, Administratori do të njoftojë menjëherë ortaket si dhe do të heqë dorë nga çdo veprim që lidhet me objektin e konfliktit të interesit deri në marrjen e udhëzimeve nga Asambleja e Përgjithshme.
- 11.5** Administratori i parë i Shoqërisë do të jetë :
- ♦ **Z. Shkelzen Narazani, lindur në Durrës, i datëlindjes 18/12/1981, mbajtës i letërnjoftimit me numër Personal: I11218058W, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar**

#### **NENI 12 SHPERBLIMI I ADMINISTRATORIT**

- 12.1** Asambleja e Përgjithshme përcakton shpërblimin e Administratorit të Shoqërisë.

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI: "YOUR TAXI" SH.P.K**  
**NENI 13**  
**PERFUNDIMI I DETYRES SE ADMINISTRATORIT**

- 13.1 Detyra e Administratorit përfundon në rast se:
- (a) i përfundon mandati;
  - (b) shkarkohet nga Asambleja e Pergjithshme;
  - (c) jep doreheqjen nga detyra duke njoftuar Shoqerine;
  - (d) personi nuk gezon cilesine e Administratorit sipas parashikimeve te ligjit;
  - (e) mungon pa arsye ne detyre per me shume se 6 (gjashte) muaj radhazi dhe Asambleja e Pergjithshme vendos ta shkarkoje nga detyra.

**KREU V**  
**KONTROLLI FINANCIAR I SHOQERISE,**  
**VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, DIVIDENDI**

**NENI 14**  
**KONTROLLI FINANCIAR**

- 14.1 Kontrolli financiar i Shoqërise kryhet në përputhje dhe sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi. Asambleja e Përgjithshme do te emëroje një apo me shume Eksperte

Kontabël te Autorizuar ne ato raste kur emvrimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet ne bazë të ligjit.

**NENI 15**  
**VITI FINANCIAR**

- 15.1 Viti Financiar i Shoqerise fillon më 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor të cdo viti.

**NENI 16**  
**BILANCI VJETOR**

- 16.1 Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, inventari, raportet e Administratorit dhe te Ekspertit Kontabel te Autorizuar (nese jane emeruar) miratohen nga Asambleja e Pergjithshme. Administratori i paraqet per miratim Asamblese se Pergjithshme raportin mbi administrimin e Shoqerise si edhe llogarite vjetore.
- 16.2 Dokumentet qe kane te bejne me vitin financiar miratohen nga Asambleja e Pergjithshme brenda 6 (gjashte) muajve nga mbyllja e vitit financiar.



## **AKT THEMELIMI DHE STATUTI: "YOUR TAXI" SH.P.K**

### **NENI 17 DIVIDENDI**

17.1 Pasi të jenë përmbushur kërkesat e përcaktuara nga Ligji për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, Shoqëria, me shumicë të kualifikuar të votave të Asamblesë së Përgjithshme, mund të vendosë shpërndarjen e dividendëve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.

17.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që i bashkëngjiten kuotave, të gjithë dividendet duhet të deklarohen dhe paguhen sipas shumave të paguara në kuotat në të cilat paguhet dividendi. Të gjitha dividendet do të shpërndahen dhe paguhen në mënyrë proporcionale me shumën e paguara mbi kuotat gjatë do të pjesë ose pjesëve të periudhës në të cilën paguhet dividendi.

**AKT THEMELIMI DHE STATUT "YOUR TAXI" SH.P.K**

**KREU VI  
PRISHJA DHE LIKUIDIMI, LIGJI I ZBATUESHEM,  
ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE**

**NENI 18  
PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE**

18.1 Ne rastin e prishjes dhe likuidimit te Shoqerise do te zbatohen dispozitat e parashikuara ne ligjin per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare.

**NENI 19  
LIGJI I ZBATUESHEM**

19.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plate me kete Akt Themelimi e Statut dhe ligjin shqiptar. Per sa nuk eshte parashikuar ne kete akt, do te zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar ne fushen e shoqerive tregtare.

**NENI 20  
ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE**

20.1 Mos marrëveshjet që mund të lindin ndërmjet Shoqerise dhe ortakeve, apo ndërmjet ortakeve dhe trashëgimtareve te ortakeve ose ortakeve te tjere dhe/ose Shoqerise, qe kane per objekt te drejta te lidhura me Shoqerine, do te zgjidhen miqesisht ndërmjet paleve te interesuara. Ne rast se palet nuk arrijne nje zgjidhje miqesore, Gjykata e Rrethit Gjyqesor Durres do te jete kompetente per zgjidhjen e mosmarreveshjeve.

Ky Akt Themelimi dhe Statut hartohet dhe nenshkruhet ne 3 (tre) kopje ne gjuhen shqipe:

**ORTAKU I VETEM I SHOQERISE: "YOUR TAXI"  
SH.P.K.**

**Shkelzen Narazani**